

**RNR në Ballkanin  
Perëndimor**

10.05.2022

**DRAFT PUNIMI PËRFUNDIMTAR**

Vizitë studimore e RNR në Ballkanin Perëndimor

28 – 29 prill 2022, Berlin

# Menaxhimi i luftëtarëve terroristë të huaj të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre

## Rezultatet kryesore

Procesi i menaxhimit të kthimit dhe rehabilitimit të luftëtarëve të huaj terroristë dhe anëtarëve të familjeve të tyre që kthehen nga (ish) territoret e lidhura me Daesh-in në Siri dhe Irak, ka të bëjë me një sërë aktorësh të ndryshëm. Është e qartë se krijimi i strukturave dhe proceseve për të lehtësuar shkëmbimin midis shumë profesionistëve dhe bashkëpunimin midis shumë palëve në lidhje me raste konkrete është thelbësor për të mundësuar veprime të bashkërenduara kur bëhet fjalë për menaxhimin e rasteve individuale, veçanërisht kur përfshihen fëmijët. Kjo do të thotë se palët e interesuara, duke përfshirë aktorët e sigurisë, organet e zbatimit të ligjit, shërbimet sociale dhe rinore, shërbimet e shëndetit (mendor), personeli i burgjeve dhe i shërbimit të lirisë me kusht, OSHC-të dhe ofruesit e programeve të de-radikalizimit, si dhe përfaqësuesit nga arsimit dhe mbështetja për punësim, që shpesh kanë këndvështrime të ndryshme dhe nivele të ndryshme informacioni, duhet të punojnë së bashku në një kuadër të besueshëm bashkëpunimi. Ky punim i përfshin njohuritë kryesore nga vizita studimore në Berlin, ku pjesëmarrësit ekspertë nga Ballkani Perëndimor patën shkëmbim me homologët e tyre nga Berlina dhe me njëri-tjetrin. Gjatë takimit, pjesëmarrësit diskutuan parakushtet për menaxhimin e suksesshëm të LHT-ve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në një mjedis me shumë agjenci dhe nxorrën mësim duke u bazuar në analizat krahasuese të qasjes së Berlinit dhe përvojave të ndryshme të Ballkanit Perëndimor.

Disa përfundime të përgjithshme dhe mësimet e nxjerra janë:

- **Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë krijuar tashmë modele funksionale bashkëpunimi dhe përvojë të konsiderueshme brenda këtyre mjediseve.** Megjithatë, integrimi i aktorëve të shoqërisë civile në këto modele mbetet i ulët.
- **Njohja ndërmjet të gjitha pikave institucionale të kontaktit në një model bashkëpunimi është kyçe** për të mundësuar bashkëpunim efektiv. Megjithatë, deri më sot, ka prirje që stafi dhe përgjegjësitë të ndryshojnë shpesh, duke krijuar vështirësi dhe nevojë shtesë për proceset e gjata të ndërtimit të besimit.
- Përveç menaxhimit të LHT-ve që kthehen nga Siria dhe Iraku, ka **një shqetësim në rritje për shkuarjen, kthimin dhe nivelin e ulët të ndjekjes penale të të kthyerve nga Ukraina** me histori të EDHKD-së. Është i nevojshëm një transferim i përvojave nga puna me të kthyerit ekstremistë islamikë në kontekstin ekstremist të krahut të djathtë.

## Çështjet kyçe të diskutimit dhe konsideratat kryesore

Përvojat në menaxhimin e LHT-ve të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre të paraqitura nga Gjermania dhe Ballkani Perëndimor tregojnë se gjithmonë nevojitet një shkallë e caktuar koordinimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë. Si rezultat i përvojave pothuajse dhjetëvjeçare me të kthyerit, si në BE ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor, theksimi i domosdoshmërisë së bashkëpunimit midis grupeve të aktorëve me ndryshime të shumta në një formë apo mënyrë është bërë i zakonshëm dhe pyetja që shtrohet sot nuk është më 'Nëse?' por 'Si?'. Për këtë qëllim, folësit dhe pjesëmarrësit u fokusuan në zbatimin aktual të strukturave për shkëmbimin e informacionit dhe për ndërmarrjen e veprimeve të bashkërenduara në një mjedis me shumë agjenci. Një theks i veçantë iu kushtua ndërtimit të besimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë. Temat e mëtejshme të diskutimit ishin zgjedhja adekuat e regjimeve të burgjeve për grupin e synuar (p.sh. seksionet e burgut të dedikuara për të kthyerit ose më mirë shpërndarja midis popullatës së përgjithshme të burgut), marrja parasysh e specifikave gjinore, trajtimi i rasteve ku përfshihen fëmijët dhe procesi i rehabilitimit, duke përfshirë rëndësinë e përgatitjes së komuniteteve pranuese për kthimin e LHT-ve.

### Krijimi i strukturave bazë për koordinimin e procesit të rehabilitimit dhe riintegrit

- **Rrjetëzimi strategjik** është hapi i parë i nevojshëm për të identifikuar dhe për të bashkuar të gjithë aktorët e nevojshëm për të punuar në rastet individuale. Ky është një proces që kërkon kohë dhe burime të konsiderueshme, të cilat duhet të merren parasysh kur krijohet një mekanizëm kthimi.
- **Niveli i lartë i largimit të personelit përgjegjës në institucionet dhe organizatat bashkëpunuese është një problem qendror për shumë praktikues.** Në shumë kontekste, anëtarët e stafit ndryshojnë shpesh, gjë që gjithmonë kërkon procese të reja të ndërtimit të besimit, duke e ngadalësuar kështu punën e mirëfilltë të bashkëpunimit. Bashkëpunimet që realizohen me një pikë të caktuar kontakti për një periudhë më të gjatë kohore kanë një shans më real për të zhvilluar mekanizma efektiv të bashkëpunimit. Kur veprohet kështu, duhet të merret parasysh aftësia vendimmarrëse e personit si përfaqësues i organizatës/institucionit të tij. Pikat e kontaktit duhet të mos ndryshojnë për një periudhë relativisht të gjatë kohore për të siguruar njohje dhe që të mos ketë ngurrim për bashkëpunim, shkëmbim të shpejtë të informacionit midis të gjitha pikave të kontaktit.
- **Sfidat e shpeshta** gjatë krijimit të bashkëpunimit midis shumë agjencive përfshijnë:
  - Interesat dhe perspektivat e ndryshme të aktorëve, veçanërisht ndërmjet palëve të interesuara të sigurisë dhe jashtë fushës së sigurisë, si dhe ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe atyre të shoqërisë civile;
  - Mungesa e kuptimit të roleve dhe ndarjes së detyrave;
  - Privatësia e të dhënave dhe pengesat për ndarjen e informacionit të ndjeshëm në lidhje me individët ndërmjet aktorëve të ndryshëm;
  - Mungesa e besimit, veçanërisht ndërmjet agjencive të sigurisë dhe punonjësve socialë (joqeveritarë).
- Për të lehtësuar procesin e përbashkët të punës, **proceset afatgjata të ndërtimit të besimit ndërmjet të gjithë aktorëve** të përfshirë janë të nevojshme për të mundësuar shkëmbimin efektiv të informacionit dhe të perspektivave (brenda kufijve të rregulloreve dhe ligjeve për mbrojtjen e të dhënave). Strategjitë e zgjidhjeve të zhvilluara në praktikë përfshijnë:
  - Mundësi për shkëmbim dhe lidhje personale në takime të formatit të vogël;
  - Ndërtimi i besimit të ndërsjellë thuhet se mund të bëhet më së miri në bazë të punës në raste aktuale (simuluese), p.sh. në formën e ushtrimeve simuluese;

- Krijimi i një pasqyre të qartë të pikave të kontaktit dhe lidhjet e drejtpërdrejta ndërmjet partnerëve bashkëpunues duke i shkëmbyer të dhënat e kontaktit;
- Rritja e të kuptuarit të roleve të njëri-tjetrit dhe përfitimeve të ndërlidhura nga çdo fushë profesionale e përfshirë, p.sh. duke:
  - I trajtuar stereotipet dhe paragjykimet në mënyrë transparente;
  - Vendosur korniza të qarta politike dhe praktike, duke përfshirë kufijtë e mandateve të secilit;
  - Inkurajuar të kuptuarit e perspektivës së njëri-tjetrit duke mundësuar njohuri transparente në proceset e vendimmarrjes.
- Komente dhe vlerësime në nivel të bashkëpunimit, jo vetëm brenda çdo organizate/institucioni përkatës, duke përfshirë mbikëqyrjen.
- **Formatet për shkëmbim të rregullt e lehtësojnë bashkëpunimin e mirë.** Shkëmbimet e planifikuara rregullisht mbi bashkëpunimin gjithëpërfshirës dhe progresin e rastit, premtojnë planifikim efektiv dhe plotësues të masave nga të gjitha palët.
  - Veç kësaj, praktikuesit theksojnë gjithashtu nevojën për një shkallë fleksibiliteti për të diskutuar rastet individuale në bazë të nevojave ad-hoc.
- Ekspertët dhe praktikuesit në shumë kontekste ende po përpiqen të **përcaktojnë nëse LHT-të e burgosur duhet të vendosen së bashku në burg**, p.sh. në seksionet e caktuara për terroristë, ose nëse duhet të integrohen brenda popullatës së të burgosurve të tjerë të burgut. Të dyja qasjet përmbajnë rreziqe dhe përfitime në lidhje me rekrutimin dhe radikalizimin e të burgosurve të tjerë, monitorimin e aktiviteteve potencialisht të dëmshme, radikalizimin dhe vlerësimin e rrezikut.
- Krijimi i një shërbimi telefonik **hotline ose kontakti me butonin e kuq** në një autoritet koordinues u diskutua si një mënyrë për të lehtësuar aksesin në një rrjet të krijuar aftësish dhe përvojësh profesionale. Në këtë mënyrë, autoritetet dhe praktikuesit me më pak përvojë në këtë fushë mund të kontaktojnë ekspertët me përvojë për të marrë mbështetje.
- **Përgatitja e përbashkët:** Kryerja e trajnimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta përgatitore para mbërritjes së të kthyerve ka ndihmuar në lehtësimin e proceseve pas mbërritjes.

## Trajtimi i nevojave të fëmijëve të kthyer

- Një sfidë e veçantë e ngritur ishte përballja me **fëmijët e LHT-ve të lindur në Siri/Irak pa certifikatë lindjeje** nga vendi i origjinës së prindërve të tyre, d.m.th. vendi ku ata u riatdhesuan. Në shumë raste, ofrimi i shërbimeve bazë sociale dhe arsimore varet nga statusi i qytetarit. Vlen të përmendet se marrja e certifikatës së lindjes mund të varet nga bashkëpunimi/vullneti i zyrtarit individual përgjegjës (p.sh. një gjyqtar i veçantë). Kjo ndonjëherë kërkon zgjidhje kreative nga ana e menaxherëve përgjegjës të rasteve. Do të ishte e dëshirueshme të krijohen rregulla dhe udhëzime të qarta për këtë proces.
  - Në shumicën e rasteve, shtetësia konfirmohet përfundimisht përmes **testimit të ADN-së** të njërit prind ose gjyshit/gjyshes, ndonjëherë edhe para riatdhesimit.
- Një sfidë tjetër kishte të bënte me **stigmatizimin e fëmijëve** në mjedisin e tyre të ri:
  - Për të përmbushur nevojat individuale të fëmijëve të kthyer, zyra e koordinimit të të kthyerve në Berlin bashkëpunon ngushtë me shërbimet e mirëqenies sociale dhe të të rinjve në rrethe të ndryshme të qytetit-shtet, duke përfshirë profesionistët e shëndetit mendor. Fokusi i tyre kryesor qëndron në integrimin e shpejtë të fëmijëve në qendrat ditore dhe në shkolla.
  - Pyetja nëse duhet të **zbulohet apo jo informacioni për sfondin e një fëmije në shkollë ose në çerdhe** mund të paraqesë një dilemë: Në disa raste mund të jetë e dobishme që mësimdhënësit dhe kujdestarët të jenë të vetëdijshëm për përgjigjet e mundshme të traumës, ndërkohë që qëllimi i përgjithshëm është të kufizojë çdo rrezik të stigmatizimit të fëmijës. Një

zgjdhje që u përmend nga praktikuesit ishte që për informacionin që konsiderohet i rëndësishëm për një fëmijë të informohet vetëm drejtori i shkollës.

- **Zonat rurale/më pak të populluara ofrojnë më pak mundësi për anonimitet për LHT-të e kthyer** dhe fëmijët e tyre. Koordinatorët dhe menaxherët e rasteve, së bashku me të gjithë personat e prekur drejtpërdrejt, duhet të shqyrtojnë me kujdes avantazhet dhe disavantazhet e mundshme të zhvendosjes në një rast të tillë.
- Fatkeqësisht, riatdhesimi dhe riintegrimi si i të rriturve ashtu edhe i fëmijëve është shpesh ende i ngadalësuar/i ndërlikuar për shkak të **rrjedhjeve të informacionit në media** dhe mjetet e informimit.

## Mbështetja e procesit të deradikalizimit dhe rehabilitimit

- Për shkak të individualitetit të secilit rast, kërkohen **qasje afatgjata të orientuara nga nevojat** në lidhje me deradikalizimin dhe punën nga distanca, duke përfshirë specifikat gjinore dhe reflektimin.
  - Megjithatë, është e rëndësishme të merret parasysh **kërkesa e lartë për praktikuesit në këtë hapësirë, të cilët janë shpesh të disponueshëm 24/7** për njerëzit me të cilët punojnë, gjë që ndikon ndjeshëm në jetën e tyre personale dhe shëndetin mendor. Njohja e këtij angazhimi mund të përkthehet në vendosjen e mbikëqyrjes dhe rritjen e shpërndarjes së burimeve ndaj vetë profesionistëve.
- Është e rëndësishme **të merret parasysh gjendja psikologjike dhe sociale e LHT-ve para se të niseshin për në Siri/Irak**. Në shumë raste, sfidat, duke përfshirë konfliktet familjare, delikucencën, përdorimin e substancave, etj. ishin të pranishme që përpara nisjes, të cilat mund të përkeqësohen nga trauma nëse të kthyerit thjesht kthehen në kontekstet e tyre para nisjes.
- Praktikuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se koha e kaluar në Siri dhe Irak shpesh karakterizohet nga **zhvillimi i mekanizmave të brendshëm të mbrojtjes dhe përpjekjeve për përballje psikologjike me situatën që kërkohen në zonën e konfliktit** për të përballuar situatën (duke përfshirë mekanizmat që i legjitimojnë veprimet (e dhunshme) të të kthyerve, që e nxisin idenë se nuk kanë pasur zgjedhje tjetër për të lehtësuar ndjenjat e përgjegjësisë dhe dëmit që e kanë shkaktuar).
  - **Refuzimi i veprimeve të veta dhe i aftësive vendimmarrëse** mund të jetë rezultat i këtyre mekanizmave për përballje me situatën dhe mund të çojë në idealizimin e këshilltarit të rehabilitimit.
  - **Mohimi i kontributit të vet ndaj vuajtjes** është një mekanizëm për përballje me situatën i bazuar në rrezikun e imazhit të lëkundur për veten. Pranimi mund të çojë në përjetimin e ndjenjave të turpërimit, pendimit, fajit, të cilat duhet të adresohen për t'u trajtuar.
- Kur të kthyerit nuk dënohen (dhe burgosen), mund të jetë e vështirë për t'i përfshirë në **përpjekjet për rehabilitim dhe shkëputje mbi baza vullnetare**. Ofrimi i shërbimeve sociale mund të jetë një qasje e dobishme për të vendosur kontakte. Shumë persona nga grupi i synuar, preferojnë kontakt me shërbimet sociale në vend të kontaktit me shërbimet e sigurisë.
- Praktikuesit raportuan se pas kthimit, disa **LHT femra krijuan një ndjenjë të vazhdueshme të viktimizimit** rreth situatës së tyre: Në këtë narrative, ato fillimisht u mashtruan për jetë të mirë të premtuar nga Daesh-i, e më pas vendi i tyre i la vetëm në kampe.
- Për personat me **nevoja të forta fetare**, përfshirja e personave me njohuri të mira të fesë, apo edhe e një imami apo përfaqësuesi të një komuniteti pozitiv fetar, mund ta lehtësojë përfshirjen pozitive në procesin gjithëpërfshirës të rehabilitimit. Në disa vende, personeli me njohuri të mira fetare përfshihet/është në dispozicion automatikisht në një qasje, ndërsa në qasje të tjera aktorët fetarë përfshihen vetëm me kërkesë të vazhdueshme të këshilltarëve.

## Rekomandime

### Rekomandime të përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin e shumë palëve për të rehabilituar LHT-të dhe anëtarët e familjeve të tyre

- **Çdo organizatë/institucion pjesëmarrës duhet të caktojë një pikë/pika (ekip) të veçantë/a kontakti për të siguruar njohjen dhe vazhdimësinë midis të gjithë partnerëve nga palë të ndryshme.**
- **Të gjitha bashkëpunimet me shumë palë duhet të bien dakord për rregulla dhe korniza të qarta për punën e tyre** për të krijuar siguri për aktorët pjesëmarrës (duke u bazuar në rregullat dhe rregulloret e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave, ndër të tjera).
- **Idealisht, partnerët duhet të kryejnë trajnime të përbashkëta dhe ushtrime simuluese duke u bazuar në raste reale përpara se të fillojnë punën e tyre.** Nëse mekanizmat e bashkëpunimit kanë filluar tashmë, rekomandohet që vëzhguesit dhe/ose vlerësuesit e jashtëm të fokusohen në procesin e vetë bashkëpunimit, në vend të aktorëve individualë.

### Rekomandime në lidhje me Ballkanin Perëndimor

- **Duhet të nxitet shkëmbimi i vazhdueshëm rajonal dhe ndërinstitutional ndërmjet profesionistëve dhe praktikuesve në rajon.**
- Lidhur me pikën e parë, **është i nevojshëm shkëmbimi i vazhdueshëm rreth fenomeneve aktuale ekstremiste në të gjithë rajonin.** Ndërsa ballafaqimi me ekstremizmin islamik dhe LHT-të mbetet një sfidë, kërcënimi i ekstremizmit të krahut të djathtë po rritet në disa nga vendet e rajonit.
  - Në dritën e luftës në Ukrainë, **duhet të kontrollohet dhe të përshtatet zbatueshmëria e ligjeve të krijuara rreth LHT-ve islamikë, për t'u marrë me EKD LHT-të që mund të kthehen.**
  - **Për më tepër, mësimet e nxjerra dhe mekanizmat e zhvilluar në kontekstin e trajtimit të ekstremizmit islamik duhet të transferohen dhe të përshtaten në trajtimin e EDHKD, një fushë ku puna praktike në Ballkanin Perëndimor mbetet e ulët.**
- **Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të mendojnë për krijimin e mekanizmave mbarëkombëtar të koordinimit për mbështetje në trajtimin e çështjeve të radikalizimit, duke përfshirë LHT-të.**
- Ndërsa shumë vende të Ballkanit Perëndimor tashmë kanë mekanizma koordinues, integrimi i partnerëve të shoqërisë civile në këto qasje shpesh mbetet i pamjaftueshëm. **Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të nxitur angazhimin e shoqërisë civile në punën e rehabilitimit dhe riintegrimin: Kjo fushë nuk duhet të mbetet e udhëhequr nga shteti (dhe siguria).**
- **Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ofrojnë mundësi financimi të udhëhequra nga shteti për nismat e shoqërisë civile dhe OJQ-ve në fushën e P/KEDH dhe rehabilitimit.** Deri më sot, termi 'OJQ' shumë shpesh ende lidhet me financimet e huaja të padëshiruara dhe problematike të aktorëve të dyshimtë, shpesh fetarë ose politikë.

## Praktikat përkatëse

1. **Ushtrimet ndërvepruese me simulim**, të organizuara nga Misioni i OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë (BdheH) në mars të vitit 2022 në Sarajevë shërbejnë si një shembull se si të sillen së bashku një gamë e gjerë përfaqësuesish ndër-sektorial, ndërqeveritar dhe të shoqërisë civile, me qëllimin për të shqyrtuar së bashku sfidat e paraqitura nga ekstremizmi i dhunshëm, me synimin për të ofruar kujdesin e nevojshëm

për qytetarët.

2. [Koordinimi i të kthyerve në Berlin](#) ka për detyrë zhvillimin e një strategjie se si të riintegrohen të kthyerit dhe krijimin e një rrjeti shumë-profesional dhe ndërdisiplinor në të cilin përcaktohen përgjegjësitë, ndahen informacionet në lidhje me rastet dhe diskutohen dhe merren masa individuale.
3. [TRIAS Berlin](#) punon në kryqëzimin e parandalimit të ekstremizmit dhe kujdesit shëndetësor. Projekti përbëhet nga dy shtylla. Përfshirja e psikoterapistëve psikologjikë në punën me klientët dhe familjet e tyre dhe ngritja e kapaciteteve në nivel të komunitetit midis parandalimit terciar dhe profesioneve të mjekësisë dhe të shëndetësisë në Berlin.
4. [Qendra e Këshillimit PREVENT në Berlin](#) ofron masa gjithëpërfshirëse të parandalimit, ndërhyrjes dhe deradikalizimit specifik në fushën e ekstremizmit me bazë fetare, duke përfshirë punëtorë parandaluesë në shkolla, trajnime të mëtejshme për stafin pedagogjik, këshillimin për prindërit dhe të afërmit, dhe shërbime të përshtatura të deradikalizimit.
5. [Qendra e Këshillimit për Radikalizimin BAMF](#) ofron një pikë të parë kontakti për individët që kërkojnë këshilla kur janë të shqetësuar se dikush që ata e njohin mund të radikalizohet drejt islamizmit dhe siguron kontakte me objekte dhe rrjete të ndryshme këshillimi në terren.

## Aktivitetet e mëtejshme

Pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor shprehën një nevojë të fortë për shkëmbime të mëtejshme ndërkombëtare dhe rajonale për të mbështetur punën e tyre dhe zhvillimin e vazhdueshëm të proceseve të punës në shtetet e tyre. Kjo mund të ofrohet lehtësisht nga RNR në Ballkanin Perëndimor përmes punëtorive të mëtejshme në rajon. Lidhur me temat, duket se është i nevojshëm një eksplorim i mëtejshëm i P/KEDH dhe veçanërisht i punës parandaluese dytësore dhe terciare në kontekstin e ekstremizmit (të dhunshëm) të krahut të djathtë.

## Materiale për lexim

Bytyqi, K., Hasanović, M. & Pereshin, A. (2021). Femrat e kthyer nga Siria në Ballkanin Perëndimor: Mes keqardhjes dhe 'nostaljisë për kalifatin'. PERSPEKTIVAT MBI TERRORIZMIN Vëllimi 15, numri 5

RNR në Ballkanin Perëndimor [Puna në P/KEDh me grupet fetare dhe me organizatat që merren me aktivitete fetare](#)

Qëndrueshmëria ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Serbi: Rasti i Sanxhakut

<https://bezbednost.org/en/publication/resilience-to-violent-extremism-in-serbia-the-case-of-sanjak/>

Migrants are leaving, but hatred remains – the anti-migrant extreme right in Serbia

<https://bezbednost.org/en/publication/migrants-are-leaving-but-hatred-remains-the-anti-migrant-extreme-right-in-serbia/>